



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbal i mbajtur më 2 shtator 2014, në mbledhjen IV – të (katërt) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.15'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesuesi i këtij Komiteti.

Fillimi i vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama, z. Radisav Perović, z. Shaban Osmani, z. Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Fadil Babatinca, Stacioni i Policisë në Podujevë, z. Farkas János, LMT- KFOR dhe Mimoza Stublla, OJQ " Balkansunflowers ".

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9 korrik 2014

z. **Liman Zeqiri**, Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, në faqen e tretë të Ekstraktit të procesverbalit, në diskutimin tim ku thuhet " Mua më brengosë numri i vogël i nxënësve në shkollat e mesme, ku prej 22 pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, mësimet i vijojnë vetëm 18 nxënës" dhe shtoi kjo duhet të korrigohet si vijon: "Mua më brengosë numri i vogël i nxënësve në shkollat e mesme, ku prej 126 nxënësve të këtyre komuniteteve, mësimet në shkollat e mesme të larta i vijojnë vetëm 18 nxënës".

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri me vërejtjen e parafolësit.

3. Përcaktimi i aktiviteteve dhe veprimeve për sensibilizimin e gjithë përfshirjes në procesin mësimor të nxënësve të komuniteteve RAE

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, viti i ri shkollor ka filluar për së mbari kësaj i ka paraprirë fakti se nxënësit e komuniteteve RAE e kanë përfunduar me sukses shkollën fillore dhe atë të mesme, mirëpo sa prej këtyre të fundit janë regjistruar në fakultete ende nuk kemi informacione.

z. **Shaban Osmani**, theksoi, është për tu përgëzuar fakti se nxënësit e komuniteteve RAE vijojnë mësimet në mënyrë të rregullt, mirëpo vijueshmëria e tyre duhet të përcillet në mënyrë permanente me qëllim të evitimit të braktisjes së

shkollimit të ndonjërit prej nxënësve. Në këtë kontekst duhet të përpilohet lista e saktë e nxënësve të cilët vijonë mësimet deri në vitin e IV të shkollës filllore, atyre deri në vitin e IX-të si dhe nxënësve të cilët vijonë mësimet në shkolla të mesme të larta, në mënyrë që asnje nxënës të mos mbetet jashtë bankave shkollore. Gjithashtu duhet interesuar edhe për ata të cilët dëshirojnë të regjistrohen në fakultete.

z. Xhafer Ademi, theksoi, në Komunën e Podujevës, viti i ri shkollor në përgjithësi ka filluar mbarë e në veçanti për nxënësit e komuniteteve RAE, këtë konstatim e mbështes duke u bazuar se të gjithë nxënësit që kanë vijuar mësimet në shkollën filllore e kanë regjistruar vitin vijues, gjithashtu ju informoj se të gjithë nxënësit që kanë mbetur në riprovim si në shkollën filllore ashtu edhe ato të mesme i kanë kryer riprovimet dhe janë regjistruar në vitin vijues.

Risi në dy vitet e fundit është se fëmijët e këtyre komuniteteve vijonë ciklin parashkollor, kjo është arritur falë krijimit të kushteve për këtë por edhe vetëdijesimit dhe interesimit të prindërve ngase janë bindur se fëmijët të cilët vijonë mësimet parashkollore arrijnë rezultate më të mira në mësime.

Këtë vit, deri tash, e kemi vetëm një student i cili ka arritur të regjistrohet në fakultet, ndërsa këtë vit në shkollim të mesëm kemi nxënës më tepër se çdo viti më parë, për këtë të fundit e falënderoj angazhimin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim e cila udhëhiqet nga z. Liman Zeqiri, gjithashtu falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, ngase janë krijuar kushte të atilla se nuk është në pyetje se a mund të regjistrohesh në shkollë të mesme, por në pyetje është se a dëshiron të regjistrohesh apo jo.

Në vijueshmërinë e nxënësve dhe sukseseve të arritura ka ndikuar edhe sigurimi i bursave e që mendoj se brenda një kohe të shkurt bursat do të ndahen edhe këtë vit shkollor.

z. Liman Zeqiri, theksoi, nëse dëshirojmë që ta integrojmë një komunitet në mënyrë të plotë në të gjitha sferat e jetës, komuniteti shumicë duhet t'i ndihmoj komuniteteve pakicë në mënyrë institucionale dhe forma të tjera. Ndjem mirë që me angazhimin tim te drejtori i Shkollës së Mesme të Lartë Ekonomike "Isa Boletini", dje është regjistruar një vajzë në atë shkollë dhe konsideroj se në këtë drejtim duhet sensibilizuar këtë çështje në mënyrë që të regjistrohen në shkolla të mesme të larta të gjithë të interesuarit dhe të mos mbetet asnje i interesuar jashtë bankave shkollore.

Në këtë kontest dëshiroj t'ju njoftoj se drejtori i Shkollës së Mesme të Lartë Ekonomike "Isa Boletini" në mënyrë publike ka premtuar, por edhe premtimin e ka mbajtur, se të gjithë nxënësit e komuniteteve RAE mund të regjistrohen në shkollën e cekur pa kurrrarë kriteri që do të thotë se kjo kategori e nxënësve nuk i nënshtrohet provimeve pranuese por pranohen në kërkesën e tyre derisa nxënësit e komunitetit shumicë i nënshtrohen provimit pranues,

z. Bahri Selimi, theksoi, lidhur me temën për të cilën po debatojmë, nga parafolësit, u shtjelluan çështje mjaftë të rëndësishme andaj nuk kam çfarë të shtoj më tepër, por konsideroj se është e rëndësishme që pas një kohe të shkurtë të na paraqiten statistikat sa nxënës dhe nxënëse janë regjistruar dhe sa kanë mbetur jashtë bankave shkollore në mënyrë që për këta të fundit të ndërmerren veprime konkrete për përfshirjen e tyre në proces mësimor.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, edhe këtë vit Komuna i ka siguruar tekstet për nxënësit e shkollave të mesme të larta për nxënës të komuniteteve RAE dhe

disa nxënësve të komunitetit shumicë me gjendje të rëndë sociale, andaj për këtë i përshëndes institucionet kompetente të Komunës.

z. Mefail Rama, theksoi, gjëzon fakti se të gjithë nxënësit e komuniteteve RAE të cilët e kanë kryer klasën e IX-të janë regjistruar në shkolla të mesme.

z. Xhafer Ademi, theksoi, me përgjegjësi them se të gjithë nxënësit të cilët e kanë kryer klasën e IX-të janë regjistruar në shkolla të mesme, me përjashtim të një vajze e cila ka dashtë të regjistrohet në shkollën e mesme të mjekësisë e që një drejtim i tillë nuk është në Podujevë, mirëpo nëse ajo dëshiron mund të regjistrohet në ndonjë shkollë të mesme të lartë në Podujevë.

z. Bahri Selimi, theksoi, jam i interesuar të di se a ka ndonjë nxënës që nuk është i përfshirë në procesin mësimor apo në atë parashkollar.

z. Xhafer Ademi, parafolësit iu përgjigj, nuk ka asnje nxënës që nuk është i përfshirë në procesin mësimor, mirëpo kjo nuk mund të thuhet sa i përket procesit parashkollar, proces për të cilin është shprehur vullneti më i madh dy vitet e fundit.

4. Të ndryshme

z. Shaban Osmani, theksoi, në mbledhjen e ardhshme do duhej të analizojmë realizimin e Planit të punës për këtë vit e në veçanti realizimin e vizitave të parapara në disa komuna të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi z. **Shaban Ahmeti**, theksoi, sa i përket vizitave kemi kontaktuar me zyrtarët kompetent të disa komunave dhe kemi shprehur gatishmërinë tonë përvizita mirëpo ende nuk kemi marr përgjigje, por mund të them se Komitetet për Komunitete të komunave tjera nuk janë të interesuara për këmbimin e përvojave.

z. Liman Zeqiri, theksoi, dëshiroj që përmes një rasti të dëshmoj korrektësinë e Institucioneve komunale përkatësisht Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – Sektorit të Strehimit, përkatësisht mënyrës së drejtë të punës të pushtetit lokal në Komunën tonë e kjo ka të bëjë me atë që Muharrem Ademi është përfitues në projektin e ndërtimit të shtëpisë të karakterit social. Në këtë aspekt jeni në dijeni se konkurrenca është mjaftë e madhe ngase një pjesë e madhe e popullsisë është në gjendje të rëndë ekonomike e sociale dhe të papunësisë së theksuar dhe në këto rrëthana, në mesin e 10 përfituesve, është përfshirë edhe i përmenduri nga radhët e komuniteteve pakicë.

z. Xhafer Ademi, theksoi, rasti që e përmendi parafolësi, është në gjendje shumë të rëndë sociale, kësaj familjeje në vazhdimësi i kanë ndihmuar qytetarë të shumtë.

Ndërtimi i shtëpisë Muharrem Ademit është punë e qëlluar dhe për këtë i falënderoj Institucionet e Komunës e në veçanti z. Liman Zeqirin, Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim i cili me angazhimin e tij ka kontribuar që një familje e komunitetit tonë të zgjidh çështjen e strehimit.

Kryesuesi z. **Shaban Ahmeti**, theksoi, kohëve të fundit një numër i madh i pjesëtarëve të komuniteteve RAE është duke emigruar jashtë shtetit kjo çështje paraqet shqetësim të madh për ne, mirëpo kjo çështje nuk është aktuale vetëm në komunën e Podujevës por në gjithë Kosovën.

z. Shaban Osmani, theksoi, komunitetet pakicë i gjelqjnë të gjitha të drejtat e mundshme e lirshëm mund të them se janë edhe të privilegjuar dhe shtoi, gjendja ekonomike dhe sociale është e njëjtë për të gjithë qytetarët pavarësisht përkatësisë etnike.

z. Xhafer Ademi, theksoi, është realitet emigrimi i një numri të madh të pjesëtarëve të komuniteteve RAE, nuk jam në dijeni për numrin e saktë por mund të them se numri i tyre është shumë i madh. Konsideroj se shkaku i emigrimit të tyre është papunësia, gjendja e rëndë ekonomike e sociale dhe pamundësia për punësim.

z. Bahri Selimi, theksoi, gjendje ekonomike dhe sociale si dhe papunësia e madhe është e njëjtë për të gjithë ne, pra kjo nuk ka të bëjë vetëm e komunitetet RAE.

Shumë të rrijë, pavarësisht përkatësisë etnike, janë duke emigruar sigurisht për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, mirëpo konsideroj se ju si komunitete pakicë i keni disa përparësi, rasti konkret që u përmend gjatë debatit lidhur me regjistrimin e një nxënëse në Shkollën e Mesme të Lartë pa kurrfarë kriteresh che pas afatit të paraparë, andaj kjo është përparësi ngase unë këdo çoftë nuk mundem me regjistruar në këtë mënyrë.

z. Mefail Rama, theksoi, me të drejtë u ngritë çështja e emigrimit të pjesëtarëve të komuniteteve RAE që është e shprehur në gjithë Kosovën. Në komunën e Podujevës afër 98% e familjeve të këtyre komuniteteve janë shfrytëzues të ndihmës sociale, për çka e përgëzoj Qendrën për Punë Sociale, mirëpo problemi qëndron në atë se familjet janë me numër të madh të anëtarëve, mbi 7 anëtarë, dhe me ndihmën sociale që e marrin nuk mund ta sigurojnë as ekzistencën.

Kriza ekonomike dhe pamundësia për punësim, çoftë edhe punë ditore fizike, janë faktor që kanë ndikuar që një numër i qytetarëve të këtyre komuniteteve t'i shesin pronat e tyre dhe t'ia mësyjnë shteteve perëndimore. Brengë e jonë është ngase ata po i shesin pronat e tyre dhe po emigrojnë por fati i tyre është shumë i pasigurt dhe mund të ndodh deri te më e keqja.

z. Liman Zeqiri, theksoi, sa i përket gjendjes ekonomike dhe sociale kjo është e njëjtë për të gjithë ne, mirëpo realiteti është se migrimi dhe emigrime janë procese që nuk ndalen kurrë.

Unë jam kryetar i Komisionit për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe mund t'ju them se për çdo ditë kemi raste të riatdhesuarve, jeni në dijeni se Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë marrëveshje me shtetet perëndimore që të gjithë ata të cilët nuk e kanë rregulluar statusin e vendqëndrimit në shtetet përkatësse të kthehen në vendin e origjinës. Kjo i përfshin si pjesëtarët e komunitetit shumicë ashtu edhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50’.

Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi

Nr. 01-006-82714
Podujevë,
2 shtator 2014

Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti